



BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Në pajtim me nenin 47, paragrafi (1), pika 6) të Ligjit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 158/10, 123/12, 43/14, 153/15, 6/16 dhe 83/18 dhe Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 110/21 dhe 74/24) dhe në pajtim me nenin 266-a, paragrafi (1) dhe (6) të Ligjit të Marrëdhënieve të Detyrueshme (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 18/01, 04/02, 05/03, 84/08, 81/09, 161/09 dhe 123/13 dhe Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 215/21 dhe 154/23), Këshilli i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut miratoi

V E N D I M **për normën e referencës së llogaritjes së** **normës gjobë të interesit**

1. Me këtë vendim, Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut (në tekstin e mëtejshëm: Banka Popullore) rregullon mënyrën e përcaktimit dhe publikimit të normës së referencës për llogaritjen e normës gjobë të interesit.

2. Norma e referencës për llogaritjen e normës gjobë të interesit për gjysëm viti të caktuar është norma e interesit të instrumentit bazë nga operacionet e tregut të hapur - bonot e thesarit të Bankës Popullore, që u arrit në ankandin e fundit në gjysëm vitin e kaluar.

Norma referencë e bonove të thesarit sipas paragrafit (1) të kësaj pike është norma e përcaktuar e interesit nga Këshilli Ekzekutiv i Bankës Popullore gjatë tenderit me shumë dhe tenderit me normë maksimale të interesit, pra norma mesatare e ponderuar e interesit gjatë tenderit me normë të interesit.

3. Norma e referencës së llogaritjes së normës gjobë të interesit publikohet në faqen e internetit të Bankës Popullore.

4. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohet vendimi për normën e referencës së llogaritjes së normës gjobë të interesit (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 42/11 dhe 49/12).

5. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e tetë nga publikimi në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Nr. 02 - 40305/8
28 nëntor 2024
Shkup

Guvernatorja
dhe kryesuesja
e Këshillit të Bankës Popullore të
Republikës së Maqedonisë së Veriut
dr Anita Angellovska-Bezhoska